



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori i Emergjencave Civile

Nr. 1976 Prot.

Puke, me 24.10.2022

P/V E N D I M

Nr. 5, Date 24.10.2022

Per perdorimin e fondit te emergjencave civile me objekt " Marrjen e masave parandaluese per riparimin e ures auto Pla Njesia Administrative Luf Qerret e demtuar nga reshjet e shirave dhe gerryerjet per rikthimin ne normalitet te levizjes se banoreve te zones.

Ne mbeshtetje të ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", të VKM Nr. 414 date 08.07.2021 "Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes se dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile " Vkm nr. 329 date 16.05.2012 " Per kriteret dhe procedurat e dhenes se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose nga fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtari njerzore" me propozim te Kryetarit te Bashkise ,Keshilli i Bashkise Puke, pasi mori ne shqyrtim dokumentacionin tekniko ligjor, diskutoi dhe ne perfundim me _____vota:

V E N D O S I:

1. Perdorimin e shumes prej 4478508 leke (kater milione e katerqint e shtate e tete mije e peseqint e tete leke nga fondi i kushtezuar emergjencave civile per vitin 2022. Sipas shkreses nr. 1007/1 Prot. Date 17.06.2022 " Mbi akordimin e fondeve te kushtezuara per vitin 2022" derguar nga Agjensia Kombetare e Mbrojtjes Civile. Per marrjen e masave parandaluese per riparimin e ures auto Pla Njesia Administrative Luf Qerret
2. Diferenca e shumes 906893 (nenteqint e gjashte mije e teteqint e nente dhjete e tre leke) leke nga vlera totale do te perdoret nga buxheti i bashkise per vitin 2023
3. Shuma Totale per marrjen e masave parandaluese per riparimin e ures Auto Pla eshte 5.385401 leke
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Sektori i Emergjencave Civile
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit 139/2015 date 17.12.2015 " Per veteqeverisjen vendore"

Drejtoria e Finances

P/ Sektorit te Emergjencave

KRYETARI

Flora PALUSHI

Behar ADEMI

Gjon GJONAJ

*Në mungesë dhe në përvojë
Spec. Financa
Mimosa Eleza
Luf*

JUFISTI

Aida JANANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE

119. 1076/129001

Pukë, më 24.10.2022

RELACION

KESHILLIT BASHKIAK

PUKE

Lenda: Per perdorimin e fondit te emergjencave civile me objekt " Marrjen e masave parandaluese per riparimin e ures auto Pla Njesia Administrative Luf Qerret e demtuar nga reshjet e shirave dhe gerryerjet per rikthimin ne normalitet te levizjes se banoreve te zones.

Si pasoje e reshjeve te shumta e te vijeshme te shiut eshte demtuar teresisht ura auto e fshatit Pla Njesia Administrative Luf Qerret duke krijuar veshtiresi ne levizjen e perditshme te banoreve te zones

Nga konstatimi ne vend kesaj ure rezultoi se duhet hartuar dhe zbatuar nje projekt teknik per ndertimin e kesaj ure per marrjen e masave parandaluese te gerryerjeve dhe levizjes normale te banoreve te zones

Gjate sezonit te reshjeve shtrati i perroit behet i pakalueshem per kembesoret por edhe per mjetet .

Mbeshtetur ne projektin e hartuar per ndertimin e kesaj ure vlere e te cilit eshte 5.385.401 leke grupi i punes parashkon marrjen e masave parandaluese per nderhyrje duke perdoror fondin e kushtezuar Emergjenca Civile ne vleren 4478508 leke per vitin 2022 dhe diferenca prej: 906893 leke te perdoret nga buxheti i bashkise per vitin 2023.

Ndertimi i kesaj ure eshte domosdoshmeri per funksionimin e jetes se banoreve te zones , parandalimin e gerryerjeve ne dy anet e perroit te cilat kufizohen me toka bujqesore, dhe levizjen e mjeteve e kembesoreve

Pergjegjes i Sektorit te Emergjencave

Behar Ademi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori i Emergjencave Civile

Nr. 12411 prot

Pukë, më 07.10.2022

V E N D I M

Nr. 9 Datë 07.10.2022.

Për verifikimin dhe marrjen e masave parandaluese për urën auto Plan Njesia Administrative Luf Qerret e demtuar plotësisht si pasoje shirarave dhe gerryerjeve

V E N D O S A:

Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e marrjen e masave parandaluese për urën auto Plan Njesia Administrative Luf Qerret Bashkia Puke gjetjen e zgjidhjeve perkatëse për riparimin e ures auto Pla Njesia Administrative Luf Qerret
Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Verqeverisjen Vendore” ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

1. Te ngrihet grupi i punes per konstatimin, vlerësimin e masave parandaluese si dhe gjetjen e zgjidhjeve perkatëse .
2. Grupi i punes përbëhet si me poshte:
 - Mustaf Kopani
 - Behar Ademi
 - Anton Lufi
3. Grupi i punes te hartoje proces verbalin e konstatimit preventivin perkates te ures auto Pla si dhe te hartoje relacionin per ne keshillin bashkiak per marrje vendimi
4. Ky urdher hyn ne fuqi menjëhere.

KRYETARI

Gjon GJONAJ



Proces verbal (Konstatimi)

I mbajtur sot me date 07 / 10 2022 ne objektin URA AUTO Luf-Qerret

Fshati Pla Njesia Administrative Luf - Qerret

Mbi verifikimin dhe vlersimin e masave parandaluese

Pë objektin URA AUTO Pla

Grupi I punes I caktuar me vendimin nr. 9 / date 7 / 10 / 2022 / me perberje

1. Mustaf Kopani

2. Behar Ademci

3. Anton Lufi

Verifikoj situaten e krijuar ne terren dhe arriti ne

konkluzion se :

Ura auto Pla eshte e deaktuar sipas saj e reshjeve
te rryveshura te shtrava dhe geryerjeve ne dyqanet
e perroit

Gjati sezoni te reshjeve shtrati i perroit behet i pakaluesh
per kembesoret dhe uqendet

ka geryerje te dyqanve te perroit ku perben
rrezik per sipor faqet e tokave bujqesore


Pas konstatimit Grupi I punes

vendosi: Duke marr ne konsiderate problemetiken
e konstatuar.

Duhet te hartohet uje projek teknik per rindertimin
e uras auto Pla
te perdorja fondi i kushte 2 var Emergjencive Civile
ose Fondi i buxhetit te beshtetur per marrjen
e masave parandale qese pe kthimin ne
normalitet te jetes dhe lirisjes se banorve te kesaj 20

Grupi I Punes

Mustaf Kopani Behar Ademci Anton Lufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Tiranë, më 17. 6 .2022



Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022

BASHKISË PUKË

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 6937/1, datë 28.04.2022 “Dërgohet miratimi për rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2022” është akorduar fondi për shumën **4,478,508 lekë**. Ky fond është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë. Përdorimi i fondeve të akorduara të bëhet në zbatim të ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 414 datë 8.07.20221 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen Civile”.

Në zbatim të pikës 7 të VKM nr. 414, datë 8.07.20221 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” duhet të raportoni (një) herë në 4 (katër) muaj, në Ministrinë e Mbrojtjes, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

Për çdo sqarim mbi zbatimin e detyrimeve ligjore mund të kontaktoni në AKMC, Znj.Marsela Sina, nr.celular 0695309900, email marsela.sina1@akmc.gov.al si dhe Znj. Floriana Braja nr.celular 0696137972, email Floriana.Braja@akmc.gov.al.

Faleminderit për bashkpunimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Haki QAKO



Relacion Teknik

Objekti:

Ura auto Plan, Bashkia Pukë

Të përgjithshme.

Fshati Plan shtrihet në territorin e Njësise Administrative Luf të Bashkisë Pukës. Ky fshat kufizohet me Qarretin në Veri dhe me Lufin në Jug. Ka resurse të mira për rritjen e prodhimeve bujqësore, si dhe në agrikulturë dhe në blegtori, këto janë favorizuar nga kushtet e mira klimatike, hidrologjike dhe tokat e përshtatshme.

Banorët e këtij komuniteti në të shumtën e rasteve nuk e kanë braktisur këtë fshat për shkak të favoreve që jep toka bujqësore dhe blegtorja, pamvarësisht kushteve jo të mira të infrastrukturës rrugore auto. Në këtë fshat ka fillësën përroi i Kçirës, dhe më poshtë saj përroi i Gomsiqes së Vogël, në këtë zonë mblidhen disa përroska përgjatë shtegimit të tij nëpër luginën e Qarretit të madh (Plani), si përroi Jazit të Majt, përroi Gurrash, përroi i Rrahut, përroi i Arrës Nezirirt, përroi i Shas, përroi Marajt, përroi Shkallash, përroi i Zanave, etj., këta përrenj kalojnë në vëndin ku propozohet të ndërtohet aksi i urës auto tip "Beli". Gjatë sezonit me reshje shiu shtrati i përroi bëhet i pakalueshëm për automjetet, si dhe për këmbësorët, duke e vështirësuar dhe duke e bërë të pamundur kapërcimin e tij. Rruga auto që kalon këtë përrua nuk ka urë auto, pasi një të tillë nuk e ka patur asnjëherë. Mungesa e kësaj ure e bën prioritet ndërtimin e saj.




Fig. 1 Pamie e përroit në aksin e propozuar në ndërtimin e urës auto (në degë e për. Gomsiaes)

2. **Punime mbistrukturore.** Është parashikuar vetëm shtresa e dërrasës me trashësi 5cm, mbi konstruksionin e gatshëm metalik ku kjo e fundit do të sigurohet nga Ministria e Mbrojtjes.




Fig. 3 Prerje gjatësore e urës auto të propozuar, sipas aksit tërthor të përroit.

3. **Punime shpatulla.** Rakordimi i urës me rrugën auto do të realizohet nëpërmjet shpatullave (mure mbajtëse - b/betoni C 7/10 me 25% gur dhe murë me gabiona), këto shpatulla do të bëjnë të mundur kanalizimin e rrjedhjes së lumit nëpër shtratin e tij të hapur, si dhe rakordimin e kuotës së urës në pjesën kaluese me të dyja anët e rrugës auto.




Fig. 3 Prerje tërthore e shpatullave të urës, të cilat lidhin urën me rrugën auto ekzistuese.

Në funksion të realizimit të tre pikave të mësipërme është llogaritur edhe kostoja e ndërtimit të urës auto, pamvarësisht mundësisë financiare, është e pamundur që të realizohet ky objekt në faza të ndara, pasi ura duke qenë një strukturë e vetme në tërësinë sajë, ajo nuk mund të ndahet, aq më tepër që ajo ka vetëm 2 pila (këmbë).

PUNOI:
ING. LAVDRIM BRUKA

Lavdrim
Bruka

Shënimet e autorit Lavdrim Bruka
Dh. 01/11/2011 nga Bruka, 01/11/2011
Dh. 01/11/2011 nga Bruka, 01/11/2011
HEC: 01/11/2011
Redaktor: Ing. the author of this
document
Date: 2011/11/20 12:28:07.00